**Akti i Themelimit dhe**

**Statuti**

**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Marseglia Green Energy"shpk**

Në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar)

Në datën 02.06.2021, ortaku i vetëm themelues:

***Shoqëria "Ital Green Energy Holding" S.r.l.;*** - shoqëri italiane, me Kod Fiskal dhe numër regjistrimi: 05431450724, i regjistrit të Shoqërive të Veronës, data e regjistrimit: 05.11.2013, themeluar me akt të datës 30.11.1999, forma juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar; Selia: San Pietro di Morubio (VR) Via Orti, 1/A CAP 37050, përfaqësuar sipas procesverbalit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, të datës 26.03.2021 dhe prokurës me nr.rep.144539, dt.30.03.2021, nga Z.***Giuseppe Lagrotta,*** i biri i Emilios, lindur në 14.04.1973, në Potenza, Itali, dhe banues në Bari-Via De Gasperi 292/D, Itali.

Shoqëria "Ital Green Energy Holding"shpk me Vendimin e Asamblesë së Shoqërisë të datës 26.03.2021, ka vendosur të themelojë shoqërinë shqiptare "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk e cila do të regjistrohet dhe do të funksionojë mbi bazën e ligjeve shqiptare, dhe këtij Statuti.

## Neni 1
## Themelimi

1. Shoqëria "Marseglia Green Energy"shpk është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria").
2. Ky emërtim i shoqërisë është i vetmi i saj dhe përdoret në të gjithë regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe ka vlefshmëri ligjore si jashtë, ashtu edhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Shoqëria ka vulën e saj identifikuese, në të cilën shkruhet: "MARSEGLIA GREEN ENERGY" shpk.

## Neni 2
## Ortakët themelues

1. Kuotat e shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk zotërohen nga ortaku i vetëm themelues i saj, shoqëria italiane "Ital Green Energy Holding"shpk.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë.
3. Ortaku i vetëm e krijon këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në pronësi private, me kontributet e veta me qëllim përfitimin financiar.
4. Me vendim të ortakut, në bazë të kritereve ligjore në të ardhmen mund të bëhet ndryshimi i kapitalit. Çdo vendim dhe akt i bërë për ndryshimin e kapitalit duhet të depozitohet ne QKB (Qendrës Kombëtare të Biznesit).

## Neni 3
## Selia e shoqërisë dhe degët

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Kajo Karafili", Pll. "Bimlaki", Kt. 1, Tiranë, Shqipëri.

2. Shoqëria ka të drejtë të operojë me degë apo zyra përfaqësimi, në të gjithë territorin e Shqipërisë apo edhe jashtë tij.
3. Degët apo zyrat e përfaqësimit krijohen me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, i cili organizon punën, përcakton mënyrën e funksionimit dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

**Neni 4**

**Objekti i shoqërisë**

1. Objekti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin aktual tregtar shqiptar do të jetë:
1. Realizimin, menaxhimin e drejtimin e qëndrave industriale teknikisht të organizuara
   A) Për blerjen,prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike dhe tregtimin e energjisë elektrike përfshi atë me shumicë, me pakicë dhe në formë elektronike, me lejet e duhura, duke përdorur biomasën, biogazin, dhe burime të tjera energjetike;
   B) Për nxjerrjen, prodhimin, shndërrimin dhe ruajtjen përkatëse të vajrave ushqimorë dhe të çdo lloji tjetër produkti bujqësor,
   C) Për prodhimin, shnëdrrimin dhe tregtimin e produkteve si ndërmjetës kimik, letër, karburantit, detergjentëve,lubrifikues dhe materialeve të biodegradueshme me origjinë natyrale ose paraprakisht natyrale, nënprodukteve të përpunimeve të vajrave vegjetale;
   D) Për prodhimin ose/dhe shndërrimin dhe ruajtjen përkatëse dhe tregtimin e estereve metilik, për metilimin e vajrave vegjetale dhe të çfarëdo lloj produkti kimik;
   E) Për përdorimin e produkteve me prejardhje nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike;
   F) Për përpunimin,tregtimin, shndërrimin,magazinimin, importin dhe eksportin e çfarëdo lloji produkti bujqësor e tregtar që ka të bëjë me produkte me perjardhje ose prurëse për bujqësinë;
   G) Negocimin e mjeteve derivate, financiare ose dhe të produkteve, që kanë të bëjnë me cfarëdo lloj vektori energjetik,gjithsesi jo në rrugë paraprirëse dhe jo kundrejt publikut, me përjashtim të veprimeve të grumbullimit të rezervuara për institutet e kreditimit dhe ato financiare;

   Shoqëria mund t'i mbështetet profesionistëve të licencuar për ushtrimin e aktiviteteve të rezervuara profesionistëve të regjistruar në librat ose regjistrat e posaçëm.

   Shoqëria, mbi të gjitha mund të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

   1. Dhënien e shërbimeve të integruara në sektorin energjetik për kryerjen dhe menaxhimin tjetër të mundshëm të ndërhyrjeve;

Ndërhyrjen globale të synuar për kursimin energjetik ose/dhe me reduktimin e kostos së ushtrimit të paisjeve në sektorin industrial, tretësor dhe për sektorin e banimeve;

A. Për prodhimin dhe shitjen e avullit, si dhe të burimeve,lëndëve dhe produkteve energjetike me natyrë tjetër, e rinovueshme dhe jo e rinovueshme, përfshi bashkëgjenerimin e energisë;

B. Dhënien e shërbimve të studimit dhe konsulencës në kuadrin e aktiviteteve të shënuara sipas gërmës A), A1), A2) si dhe projektimin, realizimin, furnizimin,menaxhimin, mirëmbajtjen e centraleve dhe të paisjeve sipas gërmave të mëparshme, qoftë për llogari të tyre,ashtu per llogari të tretëve;

C. Paraqitjen e shërbimeve që kanë lidhje me shfrytëzimin e burimeve, lëndëve, produkteve, centraleve dhe paisjeve sipas gërmave A, A1, dhe A2.

2. Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë treguese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik, në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme, në respektim të parimeve të së drejtës, ligjeve ndërkombëtare, ligjeve të shtetit shqiptar, të gjitha akteve nënligjore si dhe të përcaktimeve në këtë Statut.
3. Shoqëria në çdo kohë mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të saj.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja e shoqërisë**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk është me kohë të pacaktuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të Statutit të ri të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 6**

**Detyrimet e Ortakëve të Shoqërisë**

1. Kapitali i shoqërisë është shlyer plotësisht nga Ortaku i vetëm i shoqërisë.
2. Në çdo moment me vullnetin e ortakut të vetëm, shoqërisë mund t'i bashkohen ortakë të tjerë, në përputhje me dispozitat ligjore dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur midis palëve.
3. Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë.
4. Kur detyrimi është në natyrë duhet të shoqërohet me aktin e vlerësimit përkatës të ekspertit dhe të pranohet me vendim të Asamblesë së ortakëve.
5. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.
6. Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

7. Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 7**

**Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve;
2. Administratori.

**Neni 8**

**Asambleja e përgjithshme**

1. Asamblea e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët e shoqërisë dhe merr vendime për:
   a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
   b. Ndryshimet e statutit;
   c. Emërimin e shkarkimin e administratorëve, likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
   d. Përcaktimin e shpërblimeve për administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Autorizuar;
   e. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
   f. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
   g. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
   h. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
   i. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.
2. Asambleja e shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk në momentin e themelimit të saj, përbëhet nga ortaku i vetëm i saj, shoqëria italiane "Ital Green Energy Holding" S.r.l..

**Neni 9**

**Mbledhja e Asamblesë së përgjithshme**

1. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori, nga secili prej ortakëve ose nga likujdatori.
3. Mbledhja quhet e vlefshme nëse në të janë të pranishëm ortakët që zotërojnë të paktë 51% të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
4. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
5. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur duke respektuar procedurën e përcaktuar më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm.

## Neni 10

## Përfaqësimi në Asamble

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një akti përfaqësimi të lëshuar në favor të një personi të tretë. Autorizimi është i vlefshëm vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
2. Në rast se shoqëria do të ketë më shumë se një ortak, secili prej tyre ka të drejtën që të përfaqësojë ortakët e tjerë në mbledhjen e asamblesë, me anë të një akti të rregullt përfaqësimi.
3. Administratori, edhe nëse është ortak i shoqërisë, nuk mund të përfaqësoje ortakët e tjerë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme.

## Neni 11

## Marrja e vendimeve

1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Në momentin e themelimit kuotat e shoqërisë zotërohen në mënyrë të plotë nga ortaku i vetëm "ITAL GREEN ENERGY HOLDING"S.r.l.

1. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, videokonferencë, etj., me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me ¾ e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje, vendimet që kanë lidhje me: ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
3. Vendimet e tjera merren me shumicën e thjeshtë të ortakëve pjesëmarrës në mbledhjen e asamblesë së shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk.

## Neni 12

## Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet për sa më poshtë:
   a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
   b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare në çdo rrethanë përpara të tretëve qofshin këta autoritete shtetërore, persona juridik, vendas apo të huaj, persona fizik vendas apo të huaj, institucione financiare vendase apo të huaja;
   c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
   d) Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
   e) Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
   f) Të nënshkuajë në emër të shoqërisë çdo akt me pasoja juridike që krijon detyrime të njëanshme, të dyanshme apo transferon të drejta dhe detyrime te të tretët në emër të shoqërisë;

g) Të veprojë në cilësinë e punëdhënësit me të gjithë të drejtat që i njeh legjislacioni i punës;

h) Çdo të drejtë që i njeh legjislacioni tregtar dhe nuk i ndalohet nga ky statut.

2. Shpërblimi e administratorit përcaktohet me vendim të asamblesë së përgjithshme.
3. Mandati i administratorit të shoqërisë është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje pa limit.

**Neni 13**

**Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

1. Përveç sa parashikohet ne ligj, administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me detyrat dhe për shkeljen e standarteve profesionale, dhe kur veprimet apo mosveprimet e tij sjellin pasoja, është i detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes.

**Neni 14**

**Mënyrat e kalimit të kuotave të kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk, e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
   a) shitblerjes;
   b) trashëgimisë;
   c) dhurimit;
   ç) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Ortakët gëzojnë të drejtën e parablerjes së kuotave kundrejt një njoftimi të konfirmuar me shkrim. Ortaku blerës i mundshëm detyrohet që të japë përgjigjie brenda një afati dy mujor. Me kalimin e këtij afati shitësi i kuotave është i lirë të veprojë duke ua shitur pjesërisht apo tërësisht kuotat personave të tretë.

4.Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të transferimit të tyre.

**Neni 15**

Vitin financiar i shoqërisë fillon në 1 janar e përfundon në 31 dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet në 31 dhjetor.

**Neni 16**

**Administratori i parë**

Administratori i parë i shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk do të jetë **Giuseppe Lagrotta,** i biri i Emilios, lindur më 14.04.1973, në Potenza, Itali, dhe banues në Bari - Via Beatillo 43, Itali, qytetar italian, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Z.Giuseppe Lagrotta do të jetë në detyrë për një mandat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

**Neni 17**

**Regjistrimi i shoqërisë në QKB**

1. Administratori i shoqërisë tregtare ngarkohet të kryejë personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar, të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk, në regjistrin tregtar të "Qendres Kombëtare të Biznesit".
2. Ky Statut dhe akt themelimi, si dhe dokumentat e tjera do të depozitohen pranë regjistrit tregtar të "Qendrës Kombëtare të Biznesit".
3. Kopja e statutit dhe aktit të themelimit do të ruhen në selinë e shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk.

**Neni 18**

**Dispozita përfundimtare**

1. Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar, dispozitat e Kodit Civil, ato të sistemit fiskal, të sigurimeve shoqërore, të inspektoriatit shtetëror të punes, të Kodit të Punës, si dhe ligje të tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë, që lidhen me veprimtarine e shoqërive tregtare.
2. Ky Statut miratohet në mënyrë unanime nga ortakët dhe hyn në fuqi pas depozitimit dhe rregjistrimit në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. Statuti përpilohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe dhe italiane. Nëse midis versionit shqip dhe atij italisht të Statutit ka mospërputhje, do të ketë përparësi versionin në gjuhën italiane.

**O R T A K U**

**Themelues i Shoqërisë "Marseglia Green Energy"shpk**

**"Ital Green Energy Holding" S.r.l.**

**Përfaqësuar nga Giuseppe Lagrotta**

GIUSEPPE LAGROTTA

**Atto Costitutivo e Statuto**
**Della Società a Responsabilità Limitata**
**"*MARSEGLIA GREEN ENERGY*"shpk**

Ai sensi della Legge Nr.9901, del 14.04.2008 "Per i commercianti e le Società di Commercio" (modificata)

Il 02.06.2021 l'unico Socio fondatore:

***La società "Ital Green Energy Holding" S.r.l.;*** - Società italiana, con Codice fiscale e numero d'iscrizione: 05431450724, del Registro delle Imprese di Verona, data di iscrizione: 05.11.2013, Costituita con atto del 30.11.1999, Forma giuridica: SOCIETÀ A RESPONSABILITA' LIMITATA CON UNICO SOCIO, Sede: San Pietro di Morubio (VR) Via Orti, 1/A CAP 37050, rappresentato secondo il verbale della assemblea dei soci, di data 26.03.2021, e della procura repertorio n.144539, dt.30.0.2021, dal dr.***Lagrotta Giuseppe,*** figlio di Emilio, nato il 14.04.1973, a Potenza, Italia, e residente a Bari-Via De Gasperi 292/D, Italia.

La Società "Ital Green Energy Holding"srl con la Delibera dell Assemblea della Società di data 26.03.2021, ha deciso di costituire la Società albanese "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk, la quale si registrera e funzionare in base alle leggi albanesi relevanti, e al presente Statuto.

## Articolo 1
## La fondazione

1. La Società "MARSEGLIA GREEN ENERGY" è una persona giuridica del diritto albanese, Societa con responsabilita limitata (qui e di sotto refferita come "La Società").
2. La denominazione della Società, è unica e si usa in tutte le registrazioni, transazioni, accordi e le sue comunicazioni con i terzi, o lo stato e ha validità legale come all'estero siccome nel territorio della Repubblica d'Albania.
3. La società ha il suo timbro identificativo, con l'iscrizione: "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk.

## Articolo 2
## I soci fondatori

1. Le quote della società "MARSEGLIA GREEN ENERGY" si dispongono dal suo unico fondatore la Società italiana "Ital Green Energy Holding"srl.
2. Il capitale fondamentale della società è di 100 ALL.
3. L'unico socio crea questa società con responsabilità limitata, in proprietà privata, con i suoi contributi con lo scopo del guadagno finanziario.
4. Il capitale della società "MARSEGLIA GREEN ENERGY"srl, viene diviso in quote ed offerto dai soci che affrontano le perdite fino al limite dei valore dei loro contributi nel capitale fondamentale.
5. Con la decisione dell'unico socio, ai sensi della legge, in futuro si può cambiare il capitale. Ogni decisione e atto effettuato per il cambiamento del capitale deve essere depositata alla QKB. (Centro Nazionale dell Comercio)

## Articolo 3
## La sede della società e i suoi filiali

1. La sede della società si trova nell' indirizzo: Rruga "Kajo Karafili", Pll. "Bimbashi", Hyrja 1, Tirana.
2. La società ha il diritto di operare con le filiali o con l'ufficii di rappresentanza, in tutto il territorio della Repubblica d'Albania o anche all'estero.
3. Le filiali o gli uffici di rappresentazione si creano con la decisione dell'assemblea dei soci della società, la quale organizza il lavoro, determina il modo del funzionamento e nomina gli organi direttivi e i loro rappresentanti legali.

**Articolo 4**

**L'oggetto della società**

1. L'obiettivo della società in conformità alla legislazione attuale commerciale albanese sarà:
   1. La realizzazione, la gestione e conduzione di stabilimenti industriali tecnicamente organizzati
      A) Per l'acquisto, la produzione e la vendita di energia elettrica ed il comercio di energia elettrica compresa quella all'ingrosso, al dettaglio ed in forma elettronica, con le dovute autorizzazioni, utilizzando biomasse, biogas, ed altre fonti energetiche;
      B) Per l'estrazione, la produzione, la transformazione e la relative conservazione di oli alimentari e di ogni altro prodotto agricolo;
      C) Per la produzione, la trasformazione e la comercializzazione di prodotti quali intermedi chimici, carta, carburanti, detergenti, lubrificanti e materiali biodegradabili aventi origine naturale o prevalentemente naturale, sottoprodotti della lavorazione degli oli vegetali;
      D) Per la produzione e/o transformazione e relativa conservazione e commercializzazione di esteri metilici, per la metilazione di oli vegetali e di ogni altro prodotto chimico;
      E) Per l'utilizzazione di prodotti derivanti da fonti rinnovabili di origine naturale;
      F) Per la lavorazione, la commercializzazione, la transformazione, il magazzinaggio, l'importazione e l'esportazione di ogni tipo di prodotto agricolo e commerciale inerente prodotti derivati od afferenti all'agricoltura;
      G) Negoziazione di strumenti derivati, finanziari e/o di prodotti, relativi a qualsiasi vettore energetico compresi quelli relativi alle comodities, comunque non in via prevalente e non nei confronti del pubblico, con esclusione delle operazioni di raccolta del risparmio riservate a istituti di credito e finanziari.

   La società potrà avvalersi di professionisti abilitati per l'esercizio di attività riservate a professionist iscritti in appositi albi o registri.

   La società potrà inoltre svolgere le seguenti attività:
   1. Offerta di servizi integrati nel settore energetico per la realizzazione e l'eventuale successiva gestione di interventi;
      Interventi globali mirati al risparmio energetico e/o alla riduzione di costi di esercizio degli impianti in ambito industriale, nel terziario e per il settore abitativo;
   A. Per la produzione e la vendita di vapore, nonché di fonti, materie e prodotti energetici di altra natura, rinnovabili e non rinnovabili, ivi inclusa la cogenerazione di energia;
   B. La prestazione di servizi di studio e consulenza nell'ambito delle attività indicate di cui alle lettere A), A1) A2) nonché la progettazione, la realizzazione, la fornitura, la gestione, la manutenzione di centrali e di impianti di cui alle lettere precedenti, sia per conto proprio che per conto di terzi;
   C. La presentazione di servizi inerenti allo sfruttamento di fonti, materie, prodotti,

centrali e impianti di cui alle lettere A, A1 e A2.

2. La descrizione dell'oggetto della società è indicativa e non restrittiva in natura. Per la realizzazione del suo intento la società può collaborare con ogni persona fisica o giuridica, in ogni modo che giudica utile, nel rispetto dei principi di legge, diritto internazionale, leggi dello stato albanese, e tutti gli atti e definizioni di questo statuto;
3. La società in ogni momento può ridefinire il suo oggetto, aumentando o diminuendolo con il verdetto dell'Assemblea dei soci.

**Articolo 5**

**La durata della società**

La durata della Società "MARSEGLIA GREEN ENERGY" SHPK è di di tempo indeterminato, iniziando dalla data della registrazione nell' Centro Nazionale della Comercio.

**Articolo 6**

**Obblighi dei Soci della società**

1. Il capitale della società é complettamente liquidato dal Socio unico della società.
2. In ogni momento con la volontà dell'unico socio, alla società si possono aggiungere altri soci, in concordanza col le disposizioni legali e ai sensi delle condizioni previste nel contratto stipulato tra le parti.
3. I soci danno il loro contributo nella società in denaro oppure in natura.
4. Quando l'obbligo é in natura, deve essere accompagnato con il rispettivo atto di valutazione dell esperto ed essere accettato con il verdetto dell'Assemblea dei soci.
5. Loro sono responsabili verso la società personalmente o in modo solidare per i danni causati dal non adempimento dei loro obblighi, oppure per aver compiuto i loro obblighi oltre i limiti di tempo previsti.
6. I soci sono responsabili per le perdite della societa verso terzi fino al valore del suo contributo nel capitale fondamentale della societa.
7. I beni creati dalla società durante la sua attivita sono in proprieta dei soci. Questi beni si possono alienare, dare in comodato, lasciare come pegni nella ipoteca solo con il verdetto dell'Assemblea dei soci.

**Articolo 7**

**Organi della società**

Organi dirigenti della società sono:

1. L'Assemblea Generale dei soci;
2. L' amministratore.

**Articolo 8**

**L'Assemblea Generale**

1. L' Assemblea generale è composta da tutti soci della Società e prende le decisioni per:
   a. la determinazione delle politiche commerciali della Società;
   b. le modifiche nello statuto;
   c. la nomina e la revoca degli amministratori, dei curatori fallimentari e dei revisori contabili autorizzati;

d. la determinazione delle retribuzioni degli amministratori, dei curatori fallimentari e dei revisori contabili autorizzati;
e. l'approvazione dei rendiconti finanziari annuali e dei rapporti di andamento della attività;
f. aumento e riduzione del capitale;
g. la divisione delle quote e il loro annullamento;
h. ristrutturazione e decadimento della Società;
i. altre questioni previste dalla Legge o dallo Statuto.

2. L'Assemblea della Società "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk nel momento della sua fondazione, è composta dal suo unico socio, la societá italiana "Ital Green Energy Holding" S.r.l..

**Articolo 9**

**Convocazione dell'Assemblea Generale**

1. La riunione dell'Assemblea Generale viene convocata almeno una volta all'anno.
2. L'Assemblea Generale si convoca ogni volta che è necessario per proteggere gli interessi della società. L'assemblea generale si convoca dall'amministratore, da ognuno dei soci oppure dal curatore fallimentare.
3. La riunione viene considerata valida se sono presenti i soci che hanno in possesso almeno 51% delle quote del capitale registrato della società.
4. La radunanza dell'Assemblea Generale viene convocata attraverso una notifica trasmessa per posta o posta elettronica (e-mail) diretta ad ogni socio, incluso anche il rappresentante delle quote in comune possesso. La notifica deve essere fatta almeno 7 giorni prima della data fissata per la riunione dell'assemblea.
5. Quando l'Assemblea Generale non viene convocata rispettando la procedura determinata al di sopra, lei può prendere decisioni valide solo se ci sono tutti i soci presenti.

**Articolo 10**

**Rappresentazione in assemblea**

1. Il socio puo essere rappresentato in Assemblea generale, sulla base di un atto di rappresentanza rilasciato a favore di una terza persona. La delega é valida solo per un'Unica riunione dell'assemblea generale, compreso le riunioni seguenti con la stessa ordine giornaliera della riunione.
2. Nel caso in cui la società avrá piu di un socio, ognuno di loro ha il diritto di rappresentare gli altri soci nella riunione dell'assemblea dei soci, tramite un atto di rappresentanza regolare.
3. L'amministtratore, anche se é socio della Società, non puo' rappresentare gli altri soci alla riunione dell'Assemblea dei soci.

**Articolo 11**

**Processo decisionale**

1. Ogni quota conferisce il diritto di un voto. Al momento della costituzione le quote della Società sono interamente di proprieta' dell'Unico socio "ITAL GREEN ENERGY HOLDING"S.r.l.
2. I soci che non sono presenti possono partecipare nella riunione dell'Assemblea dei soci con diversi mezzi di comunicazione, compreso i mezzi elettronici, videoconferenza ect., con la condizione di garantire l'identificazione dei soci.

3. L'assemblea generale decide con il ¾ dei voti dei soci partecipanti alla riunione, le decisioni che riguardano: la modifica dello statuto, aumento o diminuizione del capitale registrato, distribuzione dei profitti, riorganizzazione o scioglimento della società.
4. Le altre decisioni si possono prendere a maggioranza semplice dei soci partecipanti alla riunione dell'asemblea della Società "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk.

**Articolo 12**

**Diritti e Doveri dell'Amministratore**

1. L'Amministratore ha i diritti e i doveri come segue:
   a) Effettuare tutti gli atti di amministrazione dell'attività commerciale della società, implementando le politiche commerciali stabilite dall'Assemblea Generale.
   b) Rappresentare la società di commercio in qualsiasi circostanza inanzi terzi, che siano autorità statali, persone giuridiche, nazionali o esteri, persone fisiche nazionali o esteri, istituzioni finanziari nazionali o esteri.
   c) Curare l'esatto ed il regolare mantenimento della documentazione e dei libretti contabili della società;
   d) Preparare e sottoscrivere il saldo annuale, il saldo consolidato ed il rapporto di andamento dell'attività e insieme alle proposte per la distribuzione dei profitti, presentare questi documenti dinanzi all'Assemblea generale per approvazione;
   e) Effettuare le registrazioni e inviare i dati obbligatori della società come previsto dalla Legge per il Centro Nazionale di Comercio;
   f) Sottoscrivere in nome della Società ogni atto con conseguenze legali che crea obblighi unilaterali, bilaterali oppure trasferisce diritti e obblighi ai terzi in nome della società.
   g) Agire nella qualita di datore di lavoro con tutti i diritti che le riconosce la legislazione del lavoro.
   h) Ogni diritto che le riconosce la legislazione commerciale e non è proibito da questo statuto.
2. La ricompensa dell'Amministratore è definita con il verdetto dell'Assemblea generale.
3. Il mandato dell'Amministratore della Società e di 5 anni, con il diritto di essere rieletto senza limiti.

**Articolo 13**

**Il dovere di fedeltà e responsabilità**

1. Oltre a quanto prevede la legge, l'amministratore ha l'obbligo di:
   a) Svolgere tutti i compiti che prevede la legge, opprue lo statuto in buona fede e nel migliore interesse della società, dando particolare attenzione all'impatto che la società ha sull'ambiente;
   b) Esercitare le sue competenze riconosciute dalla legge oppure dallo statuto solo per raggiungere gli obiettivi e intenzioni definite in queste disposte;
   c) Valutare con responsabilità le questioni per le quali ha responsabilità decisionale;
   d) Prevenire ed evitare i conflitti, presenti o probabili, degli interessi personali con quelli della società;
   e) Esercitare i propri doveri con profesionalita e diligenza dovuta;
2. L'amministratore durante lo svolgimento dei propri compiti ha responsabilità verso la società per qualsiasi azione o omissione che va contro i compiti assegnati oppure la violazione degli standard profesionali, e quando le azioni o omissioni portano conseguenze, e' obbligato di risarcire i danni causati da tale violazione alla società.

**Articolo 14**

**Modalità di trasferimento delle Quote di Capitale**

1. Le quote del capitale della società "Marseglia Green Energy"shpk e i diritti da loro derivanti possono essere ottenute o essere trasferite attraverso:
   a) La compravendita;
   b) L'eredità;
   c) La donazione;
   d) Ogni altra modalità prevista dalla legge.
2. In caso di trasferimento delle quote con il contrato, il contrato si deve fare per iscritto.
3. I soci godono il diritto di precomprare le quote tramite una conferma scritta. Il socio possibile compratore ha l'obbligo di rispondere entro un limite di tempo di due mesi. Oltre questo limite il venditore delle quote ha la libertà di agire liberamente per venderle parzialmente o completamente le quote ai terzi.
4. Le quote si possono dividere a causa di trasferimento.

**Articolo 15**

**L'Anno finanziario**

L'anno finanziario della societa inizia il 1 gennaio e finisce il 31 Dicembre. Escusivamente, il primo anno finanziario inizia dalla data della registrazione della societa nel Centro Nazionale della Comercio e si chiude il 31 Dicembre.

**Articolo 16**

**Primo amministratore**

Il primo amministratore della società e "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk sarà il sig. **Lagrotta Giuseppe,** figlio di Emilio, nato il 14.04.1973, a Potenza, Italia, e residente a Bari-Via Beatillo 43, Italia, cittadino italiano, maggiorenne con piena capacita giuridica di intendere e volere.

Il sig.Lagrotta Giuseppe sara in carica per un periodo di 5 anni con il diritto di essere rieletto.

**Articolo 17**

**La registrazione della società in QKB**

1. L'Amministratore della società commerciale deve essere lui personalmente o tramite persona autorizzata, a svolgere tutti gli atti necessari per la registrazione della società "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk al registro commerciale del Centro Nazionale del Comercio.
2. Questo Statuto e atto di costituzione, siccome gli altri documenti sarano depositati presso il Registro commerciale del Centro Nazionale del Comercio.
3. La copia dello statuto e dell'Atto di Costituzione si conserverano nella sede della società "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk.

**Articolo 18**

**Disposte finali**

1. Tutto ciò che non è previsto espressamente in questo statuto sara disciplinato dalla legislazione comerciale, le disposizione del Codice Civile, del sistema fiscale, delle assicurazioni sociali, dell'Ispettoriato Nazionale del Lavoro, del Codice di Lavoro,

siccome altre leggi in vigore nella Repubblica d'Albania, che riguardano l'attività delle società commerciali.

2. Questo statuto è approvato in modo unanimo dai soci ed entra in vigore dopo la deposizione e la registrazione al registro comerciale presso il Centro Nazionale del Comercio.
3. Lo statuto è compilato in quattro copie, con le stesso valore legale, in lingua albanese e italiana. Se tra la versione albanese e quella italia dello statuto ci sono discordanze, prevale la versione in ligua italiana.

**SOCIO UNICO**

**Fondatore della società "MARSEGLIA GREEN ENERGY"shpk**

**"Ital Green Energy Holding" S.r.l.**

**Rappresentata da Giuseppe Lagrotta**

GIUSEPPE LAGROTTA